



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER MARGALINA Y. DAUTI**  
**ADRESA Rruga "Muhamet Gjollësia,**  
**Pall. Moskat, shk 3, ap 14"**  
**TEL: 692204572**



# **KRIJIMI I SHOQATAVE OSE AKTI I THEMELIMIT**

**Nr. repertori: 5810**

**Nr. koleksioni: 3019**

**Tirane më 01/12/2021**

**Ligjet referuese:**

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021050360314072917



**AKTI I THEMELIMIT**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"ENE INDUSTRI" SH.P.K**

Sot, më datë 01.12.2021, para meje Notere MARGALINA Y. DAUTI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga "Muhamet Gjollësia, Pall. Moskat, shk 3, ap 14", u paraqiten personalisht:

**THEMELUESIT:**

**Shoqëria "SIKOM" sh.p.k**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L72309035A, me adresë Rruga E Barrikadave, Ish Kinema 17 Nentori, Kati 2, përfaqësuar nga Administratori **Ernest Dimashi**, atësia Thoma, amësia Roza, shtetas Shqiptar, lindur në Vithkuq, Korçë dhe banues në Tiranë, lindur më 03/05/1986, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037058796 dhe nr. personal I60503032M.

**Shoqëria "LAGIOIA STUCCHI" sh.p.k**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L62521201A, me adresë Komuna 'bradashesh', Kombinati Metalurgjik, Ish Mensa, Uzina 12, përfaqësuar nga Administratori **Nicola Lagioia**, atësia Vito, shtetas Italian, lindur në Itali dhe banues në Itali, lindur më 25/03/1964, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim Italian ID nr. CA95325HC.

**Eglis Flaga**, atësia Dijon, amësia Jolanda, shtetas Shqiptar, lindur në Ersekë, Korçë dhe banues në Elbasan, lindur më 06/12/1977, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035976457 dhe nr. personal H71206003H.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar Neni 62, pika 1, gërma "I" të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "*Për Noterinë*"

**Rrethanat për hartimin e aktit noterial:**

Personat me identitetin e mësipërm shprehën vullnetin e tyre të lirë e të plotë, për të krijuar një shoqëri tregtare, të formës shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të krijohet dhe vepron sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, si dhe do të referohet për mbarëvajtjen e saj në Aktin e Themelimit dhe Statutit të krijuar nëpërmjet këtij akti.

**I.**  
**Krijimi**

I.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin "**ENE INDUSTRI**" SH.P.K (më poshtë e quajtur "**Shoqëria**"), themelohet në bazë të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*".

**II.**  
**Objekti**

II.1 Objekt i aktivitetit të Shoqërisë është:

- Prodhim dhe perpunim i prodhimeve prej allcie, çimento dhe gipsi;



- Import-eksport dhe tregtim me shumice e pakice te allçise, çimentos, gipsit, prodhimeve prej allçie dhe cimento, kompozave te gipsit, kartonxheres, lendeve te para, makinerive teknologjike, pjese kembimi e vegla pune dhe ndertim, bojra, vajra si dhe mallrat e tjera;
- Asistence per transferimin e teknologjise dhe know-how,
- Sherbime konsulence dhe çeshtje organizative marketingu, administrative, sociale, politike dhe financiare, ne favor te subjekteve private dhe çdo veprimtari tjetër.

- II.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm.
- II.3 Shoqëria ne ushtrimin e aktivitetit te saj, do te marre te gjitha autorizimet e lejet e nevojshme prane institucioneve publike shqiptare, dhe do te mbeshtetet ne rregullat dhe normat ne fuqi ne lidhje me ushtrimin e veprimtarise se saj te rregullt ekonomik.

**III.**

**Zyra qendrore**

- III.1 Zyra qendrore e Shoqërisë është në adresën: Komuna "Bradashesh", Kombinati Metalurgjik, ish mensa, Uzina 12, Elbasan, Republika e Shqipërisë.
- III.2 Shoqëria mund të hapë zyra dhe/ose të kryejë aktivitet në vende të tjera si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit të organit kompetent ose vendimmarrës.

**IV.**

**Kohëzgjatja**

- IV.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

**V.**

**Kapitali Themeltar dhe Ortakët e Shoqërisë**

- V.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100'000 Lekë (njëqind mijë Lekë), ndarë në 3 (tre) kuota, të zotëruara nga një kuotë secili ortak .
- V.2 I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar në para nga ortakët e Shoqërisë.
- V.3 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme midis ortakëve në çdo moment sipas kushteve të parashikuara nga ligji shqiptar.
- V.4 Përgjegjësia e ortakëve për mbulimin personalisht të humbjeve të Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të tyre të nënshkruar në kapitalin e Shoqërisë.
- V.5 Përqindja e pjesëmarrjes së secilit ortak në kapitalin e Shoqërisë është:

**Shoqëria "SIKOM" sh.p.k**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L72309035A, me adresë Rruga E Barrikadave, Ish Kinema 17 Nentori, Kati 2, përfaqësuar nga Administratori **Ernest Dimashi**, atësia Thoma, amësia Roza, shtetas Shqiptar, lindur në Vithkuq, Korçë dhe banues në Tiranë, lindur më 03/05/1986, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 037058796 dhe nr. personal I60503032M, zotëruese e 33.33% të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuotë të kapitalit të barabartë me 33'333.3 leke (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pike tre leke);

**Shoqëria "LAGIOIA STUCCHI" sh.p.k**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS



A2021050360314072917

L62521201A, me adresë Komuna 'bradashesh', Kombinati Metalurgjik, Ish Mensa, Uzina 12, përfaqësuar nga Administratori **Nicola Lagioia**, atësia Vito, shtetas Italian, lindur në Itali dhe banues në Itali, lindur më 25/03/1964, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim Italian ID nr. CA95325HC, zotërues i 33.33% të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuotë të kapitalit të barabartë me 33'333.3 leke (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pike tre leke);

**Eglis Flaga**, atësia Dijon, amësia Jolanda, shtetas Shqiptar, lindur në Ersekë, Korçë dhe banues në Elbasan, lindur më 06/12/1977, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 035976457 dhe nr. personal H71206003H, zotërues i 33.34% të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuotë të kapitalit të barabartë me 33'333.4 leke (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pike kater leke);

V.6 Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë në raport me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin themeltar, domethene fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

V.7 Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë; Kapitali i shoqërisë do të hidhet në Bankë pasi të dali NIPT i shoqërisë .

V.8 *Transferimi i kapitalit*

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## VI. Organi Vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;



A2021050360314072917

f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- c) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## VII.

### Administrimi

- VII.1 Shoqëria administrohet nga një, dy ose më shumë administratorë, persona fizikë të zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.
- VII.2 Veprimet e administrimit të Shoqërisë në rast të dy administratorëve do të konsiderohen të vlefshme nëse janë ndërmarrë dhe nënshkruar nga të paktën njëri prej tyre dhe në rast të dy ose më shumë administratorëve veprimet konsiderohen të vlefshme nëse nënshkruhen të paktën nga 2 prej administratorëve të Shoqërisë.
- VII.3 Administratori emërohet për një periudhë 6 (muajore) dhe mund të riemërohet, me përjashtim të rasteve të doreheqjes ose shkarkimit të parakohshëm
- VII.4 Administratori i parë i Shoqërisë emërohet:  
**Eglis Flaga**, atësia Dijon, amësia Jolanda, shtetas Shqiptar, lindur në Ersekë, Korçë dhe banues në Elbasan, lindur më 06/12/1977, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim ID nr. 035976457 dhe nr. personal H71206003H.  
, i cili në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e perfaqësimit të shoqërisë me të tretet në gjithë veprimtarinë e saj.
- VII.5 Administratori shkarkohet nga detyra në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.
- VII.6 Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh.
- VII.7 Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë apo të tremeve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

## VIII.

### Te drejtat dhe detyrat e Ortakut:

#### Ortakut i gezonon këto të drejta kryesore:

- Administrimin e veprimtarisë në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Pjesëmarrjen në rezultatet e çdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Përgjithshme e Asamblese dhe organet e tjera të shoqërisë.
- Të heqë dorë nga shoqëria (heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ortakët nga detyrimet financiare të marra me pare ndaj shoqërisë).



A2021050360314072917

- Te marri pjese ne organet e shoqerise qe jane ose fund te krijohen nepermjet perfaqesuesit te tij ose vete.
- Te emeroje dhe te shkarkoj perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuiditorët.

**Ortaku ka keto detyrime kryesore:**

- Te depozitoj kuoten e tij dhe kuoten suplementare ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te marri pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ata.
- Ti japi shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj.
- Te kryeje detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.
- Ka detyrimin qe nese heq dore nga shoqeria ti njoftoj vendimin e tij asamblese 6 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e zgjedhjes sipas nenit .
- Ti japi shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
- Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

**IX.**

**Viti ushtrimor**

IX.1 Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik. Përfundimisht, viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregëtar dhe përfundon me 31 Dhjetor të vitit në vazhdim.

**X.**

**Mbyllja e Shoqerise:**

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga ortaku kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise (kontrata). Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likuidimi.

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i porealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për cdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

Në këtë rast Asambleja e përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

**XI.**

**Kur shoqeria likuidohet:**

Asambleja e ortakut emeron likuiditorin, dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likuidimit. Komisioni i Likuidimit perbehet nga nje ose tre anetare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare ndahen ndermjet ortakëve ne perpjestim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.



Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakut.

Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujditoreve.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 5 (pesë) ekzemplare ne gjuhën shqipe dhe italiane, secila njelloj e vlefshme.


Nënshkruar nga Ortakët Themelues sot më datë \_\_\_\_\_.

**ORTAKËT THEMELUES**

Shoqëria "SIKOM" sh.p.k  
përfaqësuar nga Administratori  
ERNES DIMITASHI  
Sh.p.k.



Shoqëria "LAGIOIA STUCCHI SH. P. K."  
përfaqësuar nga Administratori  
NICOLA LAGIOIA



EGLIS FLAGA



Në zbatim të gërmës "I" të pikës 1 të nenit 62 të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", ku parashikohet: *Kompetencat e noterit/es: l) përpilon dhe merr pjesë aktive në hartimin e akteve të shoqërive tregtare*, unë noterja marr pjesë gjatë hartimit të Aktit të Themelimit të shoqërisë.

Unë Noterja, verifikova identitetin e tyre nëpërmjet dokumenteve të identitetit cituar më sipër dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin nenit 62, pika 1, germa "ll", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti noterial, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTERE  
MARGALINA DAUTI**





A2021050360314072917

**STATUTI SHOQERISE  
"ENE INDUSTRI" shpk**

***KREU I***

***Neni 1  
Emërtimi***

Shoqëria do te emërtohet **"ENE INDUSTRI" shpk** , dhe është person juridik i të drejtës shqiptare.

***Neni 2  
Personaliteti juridik***

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **"ENE INDUSTRI" shpk** , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga:

**Shoqëria "SIKOM" sh.p.k**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L72309035A, me adresë Rruga E Barrikadave, Ish Kinema 17 Nentori, Kati 2, përfaqësuar nga Administratori **Ernest Dimashi**, atësia Thoma, amësia Roza, shtetas Shqiptar, lindur në Vithkuq, Korçë dhe banues në Tiranë, lindur më 03/05/1986, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037058796 dhe nr. personal I60503032M.

**Shoqëria "LAGIOIA STUCCHI" sh.p.k**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L62521201A, me adresë Komuna 'bradashesh', Kombinati Metalurgjik, Ish Mensa, Uzina 12, përfaqësuar nga Administratori **Nicola Lagioia**, atësia Vito, shtetas Italian, lindur në Itali dhe banues në Itali, lindur më 25/03/1964, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim Italian ID nr. CA95325HC.

**Eglis Flaga**, atësia Dijon, amësia Jolanda, shtetas Shqiptar, lindur në Ersekë, Korçë dhe banues në Elbasan, lindur më 06/12/1977, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035976457 dhe nr. personal H71206003H.

të cilët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Kontributi i ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

***Neni 3  
Selia***





A2021050360314072917

Shoqëria e ka selinë, ne adresën Komuna "Bradashesh", Kombinati Metalurgjik, ish mensa, Uzina 12, Elbasan, Republika e Shqipërisë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e tij, të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakëve.

#### Neni 4

#### Objekti i veprimtarisë

- Prodhim dhe perpunim i prodhimeve prej allcie, çimento dhe gipsi;
- Import-eksport dhe tregtim me shumice e pakice te allcise, çimentos, gipsit, prodhimeve prej allcie dhe çimento, kornizave te gipsit, kartonxheres, lendeve te para, makinerive teknologjike, pjese kembimi e vegla pune dhe ndertim, bojra, vajra si dhe mallrat e tjera;
- Asistence per transferimin e teknologjise dhe know-how,
- Sherbime konsulence dhe çeshtje organizative marketingu, administrative, sociale, politike dhe financiare, ne favor te subjekteve private dhe çdo veprimtari tjetër.

#### Neni 5

#### Kobezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

### **KREU II KAPITALI**

#### Neni 6

#### Kapitali themeltar

Shoqëria "SIKOM" sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L72309035A, me adresë Rruga E Barrikadave, Ish Kinema 17 Nentori, Kati 2, përfaqësuar nga Administratori **Ernest Dimashi**, atësia Thoma, amësia Roza, shtetas Shqiptar, lindur në Vithkuq, Korçë dhe banues në Tiranë, lindur më 03/05/1986, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 037058796 dhe nr. personal I60503032M, zotëruese e 33.33% të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuotë të kapitalit të barabartë me 33'333.3 leke (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pike tre leke);

Shoqëria "LAGIOIA STUCCHI" sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L62521201A, me adresë Komuna 'bradashesh', Kombinati Metalurgjik, Ish Mensa, Uzina 12, përfaqësuar nga Administratori **Nicola Lagioia**, atësia Vito, shtetas Italian, lindur në Itali dhe banues në Itali, lindur më 25/03/1964, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikaur me Leternjoftim Italian ID nr. CA95325HC, zotërues i 33.33% të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuotë të kapitalit të barabartë me 33'333.3 leke (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pike tre leke);

**Eglis Flaga**, atësia Dijon, amësia Jolanda, shtetas Shqiptar, lindur në Ersekë, Korçë dhe banues në Elbasan, lindur më 06/12/1977, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 035976457 dhe nr. personal H71206003H, zotërues i 33.34% të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuotë të kapitalit të barabartë me 33'333.4 leke (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pike kater leke);



Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë;

#### Neni 7

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Asamblesë përgjithshme të ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Ortakëve të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mbledhet për të marrë vendim.

#### Neni 8

#### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU II**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### Neni 9

#### Organi Vendimmarres

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

*Asambleja e përgjithshme e Ortakëve, vendos për çështje si :*



- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 10 Administrimi

Administrator i shoqërisë është Z.Eglis Flaga emëruar në këtë detyrë për një afat 6 Muaj me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë.

#### Neni 11 Kompetencat

*Administratori ka të drejtë e detyrohet të:*

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendren Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakeve edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe



A2021050360314072917

kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12  
Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaket që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakëve që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.



A2021050360314072917

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13  
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përbashimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 14  
Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15  
Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë e ngarkuar nga ana e asamblesë së ortakëve.

Ne përfundim të kontrollit auditues ligjor përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë asamblesë së ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.


Neni 16

Të ardhurat neto ( Dividenti ) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tremeve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, ortakëve të shoqërisë.

Neni 17

*Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :*

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i paralizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligji;



- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

Në këtë rast asambleja e ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

#### Neni 19

##### Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

#### Neni 20

##### Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ”

#### Neni 21



Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22  
Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008..
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasojë: kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta; bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes; vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit " pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23  
Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet në kete statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25  
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.



A2021050360314072917

Neni 26,  
Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua ne 4 ekzemplare me vlera te njejta juridike në gjuhën shqipe, dhe nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë nga ortakët themelues.

**ORTAKËT**

Shoqëria "SIKOM" sh.p.k  
përfaqësuar nga Administratori  
ERNEST DIMITRI



Shoqëria "LAGIOIA SINDRINA STUCCHI SH. P. K."  
përfaqësuar nga Administratori 62521201A  
NIGOLA LAGIOIA SINDRINA STUCCHI  
ELBASAN

*[Handwritten signature]*  
LAGIOIA SINDRINA STUCCHI

**EGLIS FLAGA**

*[Handwritten signature of Eglis Flaga]*

Në zbatim të gërmës "I" të pikës 1 të nenit 62 të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", ku parashikohet: *Kompetencat e noterit/es: I) përpilon dhe merr pjesë aktive në hartimin e akteve të shoqërive tregtare*, unë noterja marr pjesë gjatë hartimit të Statutit të shoqërisë.


Për sa më sipër, u hartua Statuti i shoqërisë me përgjegjesi te kufizuar "ENE INDUSTRI" SH.P.K , nga unë noterja, në prezencë të ortakëve të shoqërisë, bazuar në vullnetin e lirë e të plotë të tyre, si dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

Pasi u lexua qartazi dhe u kuptua rëndësia dhe efektet ligjore, nënshkruhet Statuti i shoqërisë "ENE INDUSTRI" SH.P.K sh.a me adrese ne Elbasan dhe administrator Eglis Flaga, në praninë time. Unë noterja, e vërtetoj sipas ligjit.

Unë Noterja, verifikova identitetin e tyre nëpërmjet dokumenteve të identitetit cituar më sipër dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin nenit 62, pika 1, germa "II", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti noterial, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTERE**  
**MARGALINA DAUTI**



*[Handwritten signature of Margalina Dauti]*



**ATTO COSTITUTIVO  
DELLA  
SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA  
“ENE INDUSTRI” SH.PK**

Addi, il 01.12.2021, innanzi a me Notaio MARGALINA Y. DAUTI, membro della Camera Nazionale del Notariato, Filiale Locale TIRANA, con sede all'indirizzo Tirana, Rruga “Muhamet Gjollesha, Pall. Moskat, shk 3, ap 14 “, sono comparsi personalmente:

**I COSTITUENTI :**

La società **“SIKOM” sh.p.k.**, iscritta come persona giuridica al CNB (Centro nazionale della registrazione dei Business) con un numero di unico di identificazione del soggetto NUIS L72309035A, con indirizzo Rruga E Barrikadave, Ex Cinema 17 Nentori, 2<sup>o</sup> Piano, rappresentata dall'Amministratore **Ernest Dimashi**, figlio di Thoma e di Roza, cittadino albanese, nato a Vithkuq, Korçë e residente a Tirana, nato il 03/05/1986, stato civile “coniugato”, maggiorenne, con piena capacità giuridica di agire, per l'identità del quale mi sono garantita mezzo la carta d'identità N. 037058796 e N. personale I60503032M.

La società **“LAGIOIA STUCCHI” sh.p.k.**, CNB (Centro nazionale della registrazione dei Business) con un numero di unico di identificazione del soggetto NUIS L62521201A, con indirizzo: Comune “Bradashesh”, Stabilimento Metallurgico, Ex Mensa, Stabilimento 12, rappresentata dall'Amministratore **Nicola Lagioia**, figlio di Vito, cittadino italiano, nato in Italia e residente in Italia, nato il 25/03/1964, stato civile “”, maggiorenne, con piena capacità giuridica di agire, per l'identità del quale mi sono garantita mezzo la carta d'identità italiana N. CA95325HC.

**Eglis Flaga**, figlio di Dijon e di Jolanda, cittadino albanese, nato a Ersekë, Korçë e residente ad Elbasan, nato il 06/12/1977, stato civile “divorziato”, maggiorenne, con piena capacità giuridica di agire, per l'identità del quale mi sono garantita mezzo la carta d'identità N. 035976457 e N. personale H71206003H.


**Base giuridica:** La Legge N. 9901, del 14.04.2008 “*Sui commercianti e le società commerciali*”, modificato

L'articolo 62, comma 1, lettera “I” della Legge n. 110/2018 del 20.12.2018 “*Sul Notariato*”

**Le circostanze per la redazione dell'atto notarile:**

I soggetti aventi la predetta identità hanno espresso la libera e piena volontà di costituire una società commerciale, sotto forma di società a responsabilità limitata, che sarà costituita ed opererà in conformità alla normativa vigente per le società commerciali, e farà riferimento per il suo andamento all'Atto Costitutivo ed allo Statuto creato mediante il presente atto.

KLODIAN KOVACI  
PERKTHYESI BETUAR  
TRADUTTORE GIURATO  
0698103322





## I.

### LA COSTITUZIONE

I.1 La Società a Responsabilità Limitata con la denominazione "ENE INDUSTRI" SH.P.K. (di seguito denominata "Società"), viene costituita ai sensi della legge N. 9901, del 14.04.2008 "Sui Commerciali e le Società Commerciali".

## II.

### L'OGGETTO

II.1 L'oggetto dell'attività della Società è:

- Produzione e lavorazione di manufatti in gesso, cemento e cartongesso;
- Import-export e commercio all'ingrosso e al dettaglio di gesso, cemento, cartongesso, gesso e prodotti in cemento, cornici in gesso, cartongesso, materie prime, macchinari tecnologici, pezzi di ricambio e strumenti di lavoro e costruzione, vernici, oli e altre merci;
- Assistenza per il trasferimento della tecnologia ed il know-how,
- Servizi di consulenza e marketing organizzativo, amministrativo, sociale, politico e finanziario, a favore di soggetti privati e di qualsiasi altra attività.

II.2 La Società può inoltre svolgere qualsiasi altra attività commerciale non vietata dalla legge applicabile.

II.3 La Società, nell'esercizio della propria attività, riceverà tutte le necessarie autorizzazioni e permessi dalle istituzioni pubbliche albanesi, e si baserà sulla legislazione e sulle norme vigenti in merito all'esercizio della sua regolare attività economica.

## III.

### SEDE CENTRALE

III.1 La sede della Società è all'indirizzo: Comune "Bradashesh", Stabilimento Metallurgico, Ex Mensa, Stabilimento 12, Elbasan, Repubblica d'Albania.

III.2 La società può aprire uffici e/o svolgere attività in altri paesi sia all'interno che all'esterno della Repubblica d'Albania, secondo la delibera dell'organo competente o deliberante.

## IV.

### LA DURATA

IV.1 La società svolgerà la propria attività a tempo indeterminato.

## V.

KLODIAN KOVACI  
PERKTHYESI BETUAR  
TRADUTTORE GIURATO  
0698193359



## IL CAPITALE SOCIALE E I SOCI DELLA SOCIETÀ

V.1 Il capitale sociale della Società è di 100.000 Lekë (centomila Lekë), suddiviso in 3 (tre) quote, possedute una quota da ciascun socio.

V.2 L'intero il capitale sociale è stato conferito in contanti dai soci della Società.

V.3 Le quote di capitale sono liberamente trasferibili tra i soci in qualsiasi momento alle condizioni previste dalla legge albanese.

V.4 La responsabilità dei soci per la copertura personale delle perdite della Società si estende al valore residuo del loro conferimento sottoscritto nel capitale della Società.

V.5 La percentuale di partecipazione di ciascun socio nel capitale della Società è:

La società **“SIKOM” sh.p.k.**, iscritta come persona giuridica al CNB (Centro nazionale della registrazione dei Business) con un numero di unico di identificazione del soggetto NIUS L72309035A, con indirizzo Rruga E Barrikadave, Ex Cinema 17 Nentori, 2° Piano, rappresentata dall'Amministratore **Ernest Dimashi**, figlio di Thoma e di Roza, cittadino albanese, nato a Vithkuq, Korçë e residente a Tirana, nato il 03/05/1986, stato civile “coniugato”, maggiorenne, con piena capacità giuridica di agire, identificato mezzo la carta d'identità N. 037058796 e N. personale I60503032M, titolare del 33,33% del capitale della Società, che rappresenta 1 quota di capitale pari a 33'333,3 lek (trentatremilatrecentotrentatre virgola tre lek);

La società **“LAGIOIA STUCCHI” sh.p.k.**, CNB (Centro nazionale della registrazione dei Business) con un numero di unico di identificazione del soggetto NIUS L62521201A, con indirizzo: Comune “Bradashesh”, Stabilimento Metallurgico, Ex Mensa, Stabilimento 12, rappresentata dall'Amministratore **Nicola Lagioia**, figlio di Vito, cittadino italiano, nato in Italia e residente in Italia, nato il 25/03/1964, stato civile “”, maggiorenne, con piena capacità giuridica di agire, identificato mezzo la carta d'identità italiana N. CA95325HC, titolare del 33,33% del capitale della Società, rappresentante 1 quota di capitale pari a 33'333,3 lek (trentatremilatrecentotrentatre virgola tre lek);

